



## **Këtë javë në komisionet parlamentare**

### **■ U shqyrtuan 6 nisma ligjore të rëndësishme:**

- Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021”;
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;
- Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19”;
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”;
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”
- Dekreti i Presidentit nr. 11.797, dt. 22.10.2020, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10.019, dt. 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

### **•Projekt-buxheti 2021**

- Në **Komisionin për Ekonominë dhe Financat** u prezantuan nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë prioritetet e buxhetit të vitit të ardhshëm. Seanca për diskutimin në parim të ardhurat, shpenzimet, deficitin buxhetor dhe borxhin publik të projekt-buxhetit 2021

- **Komisioni për Sigurinë Kombëtare** shqyrtoi në parim projekt-buxhetin 2021 për Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes

- **Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin** shqyrtoi në parim projekt-buxhetin 2021 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

# Këtë javë në komisionet parlamentare

- **Projekt-buxheti 2021**

- Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi në parim projekt-buxhetin 2021, për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme
- Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik shqyrtoi në parim projekt-buxhetin 2021 e Ministrisë së Kulturës, Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe fondet e dedikuara arsimit profesional

- **U zhvilluan dy seanca dëgjimore**

-Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Evis Kushi, për vitin e ri mësimor në kushtet e diktura nga COVID-19.

-Komisioni për Sigurinë Kombëtare seancë dëgjimore me gazetarin Adriatik Doçi, në lidhje me faktet e bëra publike nga ana e tij, lidhur me çështjen e dhënies së shtetësive nga ana e Presidentit të Republikës

## Seanca plenare

### **Kuvendi miratoi 2 projektligje, një Akt Normativ dhe një projektvendim. U rrëzua një Dekret i Presidentit të Republikës**

Kuvendi u mbledh në seancë plenare dhe miratoi dy projektligje, një Akt Normativ dhe një projektvendim:

- “Për ratifikimin e marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (COVAX Facility)”;

- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014”Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”;

- Aktin Normativ me fuqinë e ligjit, nr.31, dt. 7. 10. 2020, “Për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura gjatë periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore”;

-Projektvendimin “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik (KPK)”.

-Seanca votoi kundër dekretit presidencial nr. 11.797, dt. 22.10.2020, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10.019, dt. 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Në nisje të seancës u zhvillua një interpelancë me ministrin e Shtetit për Rindërtimin, z.Arben Ahmetaj, e kërkuar nga deputeti Halit Valteri lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe procesin e rindërtimit.

## Aktivite parlamentare

### **21 Kuvendi i Shqipërisë organizoi Forumin e parë Ballkanik Kundër Anti-Semitizmit: Sekretari i Shtetit Pompeo dhe Presidenti i PE, Sassoli, folës special në Forum**

**28 Tetor 2020** - Kuvendi i Shqipërisë, në partneritet me Lëvizjen Kundër Anti-Semitizmit dhe Agjencinë për Hebrenjtë të Izraelit, organizuan Forumin e parë Ballkanik Kundër Anti-Semitizmit, (on-line). Forumi, i iniciuar nga z.Taulant Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar socialist, u zhvillua pas miratimit të Rezolutës “Për miratimin e përkufizimit të përdorshëm për antisemitizmin, përcaktuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit”, në seancën plenare të datës 22 tetor 2020. Të ftuar dhe folës special në Forum ishin Sekretari i Shtetit i ShBA, Michael R. Pompeo dhe Presidenti i Parlamentit European David Maria Sassoli. Në Forum morën pjesë personalitete të larta nga vendi, rajoni, Izraeli dhe SHBA. Kryetari i Qendrës për Ndikim Hebraik, z. Robert Singer, dhe Kryetari i Agjencisë Hebraike për Izraelin, z. Isaac Herzog, i dorëzuan Kryetarit të Kuvendit z. Gramoz Ruçi, Çmimin e Lëvizjes për Luftën kundër Anti-Semitizmit, për miratimin e përkufizimit të IHRA. Forumi u çel nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, z. Taulant Balla, i cili nënvizoi se “Humanizmi i shprehur ndaj çdo komuniteti në rrezik, toleranca ndër-fetare dhe vlera të tjera të popullit shqiptar vlejné të përmenden, veçanërisht për të luftuar synimet e atyre që provokojné frymën e konfliktit dhe intolerancës.”

Në fjalën e tij, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, nënvizoi se “Shqiptarët bota i njohu si magjistratët e mbrojtjes së hebrenjve, pa dallim besimi fetar, pasurie, territori, orientimi politik, duke shënuar një konvergencë kombëtare si rrallë herë në historinë tonë. Lufta kundër antisemitizmit nuk mbron vetëm një komb, por është pjesë e projektit të njerëzimit për një botë me mirëqenie, siguri, paqe e drejtësi. Liderhipi i Shqipërisë në këtë luftë buron sa nga historia dhe ekzistenca, aq edhe nga aspiratat tona drejt Bashkimit European; nga anëtarësia në NATO; nga aleanca kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm ndaj komuniteteve, pakicave, refugjatëve, emigrantëve, të dobëtëve; nga partneriteti për të mbrojtur të ardhmen tonë prej “demokratizimit” të dhunës, i cili shoqëron atë që ne e quajmë “demokratizimi i teknologjisë”.”

Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, në fjalën e tij nënvizoi, midis të tjerash se “Shqipëria ka pasur privilegjin dhe nderin që të jetë kryetare e OSBE-së dhe gjatë Kryesisë sonë, ne kemi vendosur theksin saktësisht në çështjen e antisemitizmit, në bashkëpunim me shumë aktorë, përfshirë shoqërinë civile, me qëllim që të përpiqemi të ndërjegjësojmë sa më shumë të jetë e mundur se antisemitizmi është një kërcënim real, i cili shkon mjaft përtej asaj çka duket se shënjestron”.

Sekretari i Shtetit i ShBA, Michael R. Pompeo, në përshëndetjen e tij, theksoi se “Ne jemi sot këtu sepse fatkeqësisht anti-Semitizmi është ende me ne. Ne kemi përgjegjësinë, si dhe ata para nesh, ta shtypim atë dhe mund ta bëjmë. Së pari, duhet ta përcaktojmë këtë kërcënim dhe ta kuptojmë qartë”. Ai i bëri thirrje vendeve dhe shoqërive të tjera të miratojnë përkufizimin e IHRA-s për anti-Semitizmin, i cili u miratua nga qeveria federale e Shteteve të Bashkuara pas Urdhrit Ekzekutiv të Presidentit Trump, në dhjetor të vitit të kaluar.

Presidenti i Parlamentit European David Sassoli theksoi se “E vërteta e turpshme dhe e trishtuar është se më 2020, 74 vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, mjaft hebrenj në Europë nuk mund të jetojnë një jetë të lirë e të pashqetësuar. Kjo tregon se ne kurrën uk duhet të pushojmë, kurrë nuk duhet të ndalojmë, kurrë nuk duhet t’i lejojmë vetes të mendojmë se historia që ne besonim se ndodhi mbi 75 vjet më parë nuk mund të përsëritet. Shqipëria është një vend që duhet marrë shembull.”

### **Konferenca e Kryetarëve shqyrtoi kalendarin e veçantë të rishikuar të shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”**

**29 tetor 2020** - Konferenca e Kryetarëve, e mbledhur nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, shqyrtoi kalendarin e veçantë të rishikuar të shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”, miratuar me vendimin nr. 27, datë 21.10.2020 të Konferencës së Kryetarëve. Konferenca vendosi t’ia paraqesë kalendarin e veçantë të rishikuar të shqyrtimit të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021” për shqyrtim e miratim seancës plenare. Konferenca e Kryetarëve u zhvillua me anë të mjetit të komunikimit elektronik (Cisco Webex).

## Aktivite të Kryetarit të Kuvendit



**26 tetor 2020**

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ngushëllime për ndarjen nga jeta të Zëvendës-presidentit të Bundestagut, Opperman: Iku një politikan dhe ligjvënës i klasit të lartë

**26 tetor 2020**

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, uron kryeparlamentarin austriak Sobotka me rastin e Festës Kombëtare: Mirënjohje Austrisë, avokates së integrimit evropian të Shqipërisë



**27 tetor 2020**

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti Ambasadorin e Kuvajtit, z. Fayeze Mishari al-Jassim



## Aktivite të Kryetarit të Kuvendit

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, uron Kryeparlamentarin e Çekisë Vondráček, për Ditën Kombëtare: Republika Çeke, mike dhe partnere e Shqipërisë**

**28 tetor 2020** - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i ka dërguar një letër urimi Kryetarit të Dhomës së Deputetëve të Republikës Çeke, z. Radek Vondráček, me rastin e 28 Tetorit, Ditës Kombëtare. “Me rastin e Ditës Kombëtare të Republikës Çeke, Ju dërgoj urimet më të përzemërta Ju, Dhomës së Deputetëve dhe popullit mik çek. Republika Çeke është një vend mik dhe partnere e mbështetëse e fuqishme e Shqipërisë. Kjo miqësi buron nga historia, marrëdhëniet tradicionale dhe respekti reciprok të dy popujve tanë për njëri-tjetrin. Republika Çeke është gjithashtu një mbështetëse, nxitëse dhe inkurajuese e rrugëtimit tonë europian. Së bashku me vendet e tjera të Grupit të Vishegradit, ju jeni bërë promotorë të çeljes sa më shpejt të negociatave me Shqipërinë. Vendimi i marrë nga Këshilli i Bashkimit Europian në datën 25 mars 2020 për hapjen e negociatave, i bazuar në progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara nga Këshilli, është rezultat edhe i kontributit të Republikës Çeke. Mbështetja e Dhomës së Deputetëve dhe e Juaja personalisht ka qenë një faktor nxitës për çeljen e negociatave, për të cilën populli shqiptar Ju është thellësisht mirënjohës.”, shkruan në letrën e urimit Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, uron Kryeparlamentarin e Turqisë, Sentop, për Ditën e Republikës: Atatürk themeloi një Republikë laike e moderne, me prirje liberale e demokratike**

**29 tetor 2020** – Me rastin e Ditës së Republikës, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i ka dërguar një letër urimi Presidentit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë, z. Mustafa Sentop. “Shpallja rreth një shekull më parë, më 29 tetor të vitit 1923, e Republikës së Turqisë prej burrit të madh të shtetit, Mustafa Qemal Atatürk, ishte një sukses historik i Turqisë. Si Presidenti i parë i Republikës së Turqisë, Atatürk hodhi themelet për një shtet të pavarur, laik, modern dhe krijoi premisat për zhvillimin e prirjeve liberale e demokratike në Turqi. Populli shqiptar dhe Kuvendi i Shqipërisë ndjekin me gëzim arritjet e Turqisë mike, partneres së Shqipërisë në NATO, dhe urojnë avancim të mëtejshëm në rrugën e progresit, mirëqenies e demokracisë, si dhe mirëpresin rritjen e kontributit për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon e më gjerë. Themelimi i Republikës së Turqisë kremtohet në një kohë të vështirë për Turqinë, Shqipërinë, rajonin, Europën dhe botën, betejën me pandeminë e COVID-19. Siç edhe kemi pasur kënaqësinë të diskutojmë, shpresojmë dhe urojmë që vendet tona dhe popujt e tjerë të planetit, ta fitojnë këtë betejë të vështirë dhe të rikthehen në jetën normale. Gjithashtu, kam kënaqësinë të konstatoj se Kuvendi i Shqipërisë dhe Asambleja e Madhe Kombëtare e Turqisë kanë rifilluar dhe do të vazhdojnë të intensifikojnë bashkëpunimin e shkëlqyer midis tyre.”, shkruan në letrën e urimit Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, mesazh për ndarjen nga jeta të artistit të madh Avni Mula: “Kolonë zanore” e jetës shqiptare**

**30 tetor 2020** - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, ka sot një mesazh për ndarjen nga jeta të artistit të madh Avni Mula. “Avni Mula ishte një artist i kalibrit të lartë, kompozitor i madh dhe këngëtar i shquar. Disa breza shqiptarësh u rritën dhe u frymëzuan nga këngët e tij. Avni Mula i këndoi Shqipërisë si rrallëkush. Këngët e tij u bënë një “kolonë zanore” e jetës së shqiptarëve. Ai krijoi një art të madh, por edhe një familje të madhe artistësh.”, shkruan në mesazhin e tij Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

## Aktivitete të Kryetarit të Kuvendit

### **Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, letër falenderimi Sekretarit të Shtetit Pompeo: Shqipëria do ta përmbushë misionin për ta shndërruar luftën kundër Anti-Semitizmit në çështje të të gjithë rajonit**

**30 tetor 2020** -Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i dërguar një letër falenderimi Sekretarit të Shtetit, z. Michael R. Pompeo, për pjesëmarrjen dhe mesazhet në Forumin Ballkanik Kundër Anti-Semitizmit, organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në partneritet me Lëvizjen Kundër Anti-Semitizmit dhe Agjencinë për Hebrejtë të Izraelit, më 28 tetor 2020. “Dëshiroj t’Ju shpreh mirënjohjen time, të Kuvendit të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar, për pjesëmarrjen dhe videomesazhin Tuaj në Forumin Ballkanik Kundër Anti-Semitizmit, organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në partneritet me Lëvizjen Kundër Anti-Semitizmit dhe Agjencinë për Hebrejtë të Izraelit, më 28 tetor 2020. Ne, shqiptarët, jemi krenarë që për rreth dymijë vjet të historisë sonë kemi pasur marrëdhënie të shkëlqyera me hebrejtë dhe i kemi mbrojtur ata në momente të vështira të historisë së tyre. Ne sot çmojmë lart bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, hebrejtë dhe Shtetin e Izraelit, në qëndrimet dhe përpjekjet tona të përbashkëta kundër Anti-Semitizmit. Siç theksuat edhe Ju në fjalën Tuaj, ne jemi sot bashkë “Sepse fatkeqësisht anti-Semitizmi është ende i pranishëm. Ne kemi përgjegjësinë, si dhe ata para nesh, ta mundim atë dhe mund ta bëjmë. Së pari, duhet ta përcaktojmë këtë kërcënim dhe ta kuptojmë qartë atë.” Forumi i parë Ballkanik Kundër Anti-Semitizmit si edhe Rezoluta “Për miratimin e përkufizimit të përdorshëm për Anti-Semitizmin, përcaktuar nga Aleanca Ndërkombëtare për Përkujtimin e Holokaustit”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në prag të Forumit, më 22 tetor 2020, janë një lartësim prej Kuvendit të Shqipërisë, i ndjenjave e qëndrimeve të njohura botërisht të popullit shqiptar për mbrojtjen e hebrejve si edhe një kontribut në shndërrimin e Shqipërisë në një lider rajonal të frontit të bashkuar të luftës kundër Anti-Semitizmit, racizmit, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Lufta kundër Anti-Semitizmit nuk mbron vetëm një komb, por është pjesë e projektit të njerëzimit për një botë me mirëqenie, siguri, paqe e drejtësi. Dëshiroj t’Ju siguroj se Shqipëria do ta shpjer deri në fund misionin e saj për ta shndërruar luftën kundër Anti-Semitizmit në çështje të të gjithë rajonit. Duke e merituar për të qenë në krye të këtij fronti, ne afirmojmë identitetin e vlerat tona europiane, qytetëruese e perëndimore.”, shkruan Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, në letrën e falenderimit, dërguar Sekretarit të Shtetit Pompeo.

### **Pas tërmetit në Sanos dhe Izmir, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, telegram homologëve Sentop dhe Tassoulas: Goditja e natyrës nuk do të thyejë fqinjët tanë**

**30 tetor 2020-** Pas tërmetit të fortë të ditës së sotme në Egje, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, u është drejtuar me telegram Kryetarit të Parlamentit të Turqisë, z. Mustafa Sentop, dhe Kryetarit të Parlamentit të Greqisë, z. Constantine Tassoulas.

“Me tronditje mora lajmin për tërmetin shumë të fortë që goditi sot në mesditë Sanmosin, Izmirin dhe zonat perreth. Në këto çaste të rënda, Kuvendi i Shqipërisë dhe gjithë populli shqiptar, janë pranë popujve tanë miq e fqinj dhe shprehim dhimbjen e solidaritetin me qytetarët dhe familjarët e viktimave. Jam i bindur se kjo goditje e natyrës nuk do t’i gjuhëzojë fqinjët tanë, me të cilët kemi ndarë, ndajmë e do të ndajmë gëzimet dhe pasojat e fatkeqësive.”, shkruan Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.